

	E bëri Esi nga Antje Dam
	Kjo është Ida. Ida ka një një arush pelushi, të cilin ajo e quan Esi.
	Ida ha në mëngjes bukë me reçel mjedre dhe pi një filxhan kakao. Ai derdhet. Atëherë mamaja zemërohet dhe thotë: - Çfarë rrëmuje, nuk mund të tregosh kujdes ti, Ida? Ida i thotë: E bëri Esi. Esi nuk thotë asgjë, sepse Esi nuk mund të flasë. Esi është një arush pelushi. Prandaj, Esi nuk mund të ulet më në tavolinë në mëngjes.
	Mamaja del shëtitje me Idën. - Mund të mbledhim gështenja, - propozon ajo. Jashtë është i ftohti i zi. Por, Ida sot nuk do të veshë kapele, sepse ka dy gërsheta. Mamaja e nxjerr kapelen nga pellgu. - E bëri Esi, - thërret Ida. Prandaj, edhe Esi merr një kapele.



Mamaja blen salsiçe për drekë.
Idës i duket argëtuese të bëjë pazaret.
Edhe ajo blen diçka.
Por, mamaja nuk do as karamele prej xhelatine, as akullore dhe mbi të gjitha nuk do karamele marshmallow në formën e një miushi.
Prandaj Ida thërret shumë fort:

- E bëri Esi.

Dhe meqë Ida e thotë këtë gjë me zë kaq të lartë, shitësja i dhuron dy karamele.
Esi nuk merr asnjë.



Më pas, Ida fle pak gjumë në drekë, edhe pse ajo nuk është aspak e lodhur.
Ajo ka më shumë dëshirë për diçka tjetër.
Por, mamaja nuk i do vizatimet e mëdhaja, aq më pak mbi qilim.

- E bëri Esi!, - thotë Ida dhe merr nga mamaja një fletore vizatimi.
- Tani, Esi mund të vizatojë shumë mirë. – thotë Ida.



Pasdite Ida luan me Benin.
Beni ndërton një kullë të lartë me lodra në formë tullash.
Por, Ida ka më shumë dëshirë të luajë me kukulla.
Kur Beni qan, Ida thërret:

- E bëri Esi!

Esi fluturon në dhomë dhe nuk lejohet të luajë më.

	Ndërkohë mamaja vjen në dhomë dhe thotë: - Besoj se Esi duhet flejë pak, se kështu nuk mund të bëjë kaq shumë rrëmujë. Pikërisht, atëherë Ida tund kokën dhe e shtrin Esin në krevat. Më në fund është qetësi dhe nuk mund të ndodhë më asgjë.
	Në darkë Ida lan dhëmbët dhe duart. Esi është krejt e bardhë. Babai thotë: - Kremi i mirë! Do të bërtasë mamaja për këtë gjë... Ida thotë: - E bëri Esi Dhe, e qorton shumë Esin. Kështu që, Esi edhe duhet të lahet.
	Tashmë Esi është qull e lagur dhe duhet të mbështillet me një peshqir banjoje, sepse do të shtrihet në krevat me Idën. Për fat të mirë e ka kokën jashtë, kështu që mund të shohë diçka.
	Kur babai e çon Idën të flejë në krevat, duhet t'i këndojë shtatë këngë që ajo të flejë, madje edhe me zë të lartë. Pastaj, ai merr një puthje. - Faleminderit, Esi, - thotë babai i përgjumur. - Këtë nuk e bëri Esi, - i thotë Ida e tërbuar. E bëra unë. Atëherë babai u gëzua me të vërtetë.



Dhe pastaj, Esi merr një puthje nga Ida.

- Natën e mirë, Esi. Nesër do të jesh tharë, por nuk do të bësh më kaq shumë rrëmujë.

Dhe, atëherë Esi u gëzua shumë.

Fund



Fund